



Datë: 25.02.2025
Numër Protokolli: 1452/2025

A.nr.44/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.44/2025 të datës 09.01.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Sh, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 25.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.44/2025 e datës 09.01.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Sh.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi) i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 09.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos zbatimit të vendimit me numër protokolli 335/2024 të datës 19.09.2024 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe mos përputhjes së gjendjes faktike së vlerësuar nga KPMSHCK, në Vendimin e datës 24.12.2024, të ankesës paraprake.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 30.01.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, (më tej Kolegji i Këshillit) pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore në ndërlidhje me provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjegjësisht sipas Akt emërimit të datës 06.10.2003 i njëjti është punësuar në pozitën e punës *Oficer Sigurie*, ndërsa aktualisht sipas Kontratës së Punës të datës

30.06.2018, ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar Korrektues* në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Tutje sipas shkresave të lëndës rrjedhë se me vendimin me numër protokolli Nr.335 të datës 19.09.2024, Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka aprovuar kërkesën e ankuesit të datës 12.06.2024 duke i njohur të drejtën e kompensimit në shumën prej 363.00 euro dhe mbi bazën e arsytimit: *Ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës në SHKK me datë 16.10.2003 dhe me datë 16.10.2023 i njëjti ka mbushur 20 vite pune në SHKK. Andaj, duke qenë se ankuesi nuk ka përfituar nga paga jubilarë, aprovohet kërkesa për shpërblim jubilar i kompensohet shuma në vlerë prej 363.00 euro, duke llogaritur kohën nga themelimi i marrëdhënies së punës e deri në janar të vitit 2023, krejt kjo duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.2.1 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, dispozita këto ligjore në fuqi deri me datë 05.02.2023, kur Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka shfuqizuar këto dispozita.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmerisë së ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë, nisur nga ky përcaktim ligjor, dhe duke u bazuar në administrimin e provave materiale të çështjes, Kolegji erdhi në konstatimin se ankuesi lidhur me realizmin e të drejtës në kompensim të shpërblimit jubilar sipas Vendimit numër protokolli Nr.335 të datës 19.09.2024, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përsëri nuk ka parashtruar kërkesë tek organi përkatës i punësimit, dhe si për pasojë nuk kemi veprim apo mos veprim administrativ të organit të punësimit që pretendohet se mund të ketë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme të ankuesit.*

Rrjedhimisht, në kuptim të së drejtës së ankuesit në mbrojtje juridike, Kolegji ri-thekson faktin se ankuesi fillimisht duhet t'i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës së pretenduar dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo kundër heshtjes së organit publik në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtroj ankesë në Këshill, duke respektuar afatet ligjore siç parashihen me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që bazuar si më lartë, Kolegji vlerëson se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.44/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit A.Sh;*
- *Menaxherit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*